



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

PROCESVERBAL

Tiranë, më 11.09.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Fatjona Dhimitri – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11256, datë 08.08.2019 “Për kthimin e ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” (*komision përgjegjës*).

Marrin pjesë:

Fatjona Dhimitri, Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhambulla, Klajdi Qama, Kostaq Papa, Selami Jenishehri dhe Ramazan Gjuzi.

Mungojnë:

Enada Kapllani.

Të ftuar:

Krisilda Fana - drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Sigurisë në Presidencë,
Vasil Tole – akademik, zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave,
Erzen Tola - drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

HAPET MBLEDHJA

Fatjona Dhimitri – Përshëndetje!

Mirë se erdhët në mbledhjen e radhës së komisionit!

Falënderoj mediet për gatishmërinë dhe praninë e tyre në këtë mbledhje të komisionit!

Sot në rendin e ditës kemi shqyrtimin e dekretit të Presidentit të Republikës nr. 11256, datë 08.08.2019 “Për kthimin e ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, depozituar më 09.08.2019.

Presidenti me dekretin e tij ka vendosur kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” me qëllim rishikimin dhe përmirësimin e pikës 1, të nenit 3; pikave 3, 7 dhe 14 të nenit 4; pikës 3 të nenit 6; pikave 3 dhe 6 të nenit 11; pikës 1 të nenit 15, si dhe të pikës 1 të nenit 19, sipas arsytimit, i cili gjendet bashkëlidhur dekretit, të cilin e disponojnë edhe *online* të gjithë anëtarët e komisionit.

Të ftuar nga institucioni i Presidencës janë zoti Bledar Dervishaj, këshilltar ligjor i Presidentit. A është i pranishëm zoti Dervishaj?

Nuk është i pranishëm.

Zonja Krisilda Fana, drejtore e Drejtorisë Juridike dhe Sigurisë. Nga grupi i ekspertëve zoti Skënder Gjinushi. Nuk është i pranishëm?

Vasil Tole – Zoti Gjinushi nuk është i pranishëm, por jam unë, si zëvendëskryetar i Akademisë.

Fatjona Dhimitri – Zoti Tole, ju keni qenë i pranishëm në të gjitha mbledhjet tona të komisionit dhe mendoj se keni qenë një ndër personat mbështetës të këtij projektligji. A ka ndonjë mendim tjetër alternativ apo ndonjë ekspert tjetër nga Akademia që të ishte i pranishëm në komision përveç jush?

Vasil Tole – Zonja kryetare, ne kemi marrë një njoftim zyrtar nga komisioni juaj për të caktuar përfaqësuesin tonë në këtë takim dhe anëtarët e Akademisë kanë gjykuar që unë do të jem përfaqësuesi i saj për këtë takim.

Fatjona Dhimitri – Nëse ligji ka për qëllim dekompozimin e Akademisë së Shkencave, vetëm ju do të ishit i pranishëm këtu.

Vasil Tole – Nuk e di nëse është term i përshtatshëm fjala “dekompozim”, e cili përdoret zakonisht për produktet bujqësore...

Fatjona Dhimitri – I pranishëm nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë është zoti Erzen Tola, drejtor i Përgjithshëm në Drejtorinë e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MASR.

Fjalën e ka përfaqësuesja e Presidentit për të na dhënë shpjegimet në lidhje me dekretin e Presidentit.

Krisilda Fana – Faleminderit, zonja kryetare!

Ashtu siç kemi shprehur edhe me dekretin e Presidentit, edhe me arsyetimin bashkëlidhur, Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 18 korrik ka miratuar ndër të tjera edhe ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”. Me shkresën nr. 2980, të datës 24.07.2019 të Kuvendit ky ligj është përcjellë për dekretim dhe shpallje, dhe është administruar në institucionin e Presidentit të Republikës me numër protokolli 2592, datë 24.07.2019. Presidenti i Republikës shqyrtoi ligjin nr. 53/2019, duke iu referuar përmbajtjes së aktit të dërguar për dekretim dhe shpallje, praktikës parlamentare të ndjekur për këtë qëllim, duke vlerësuar përputhshmërinë e këtij ligji me parimet dhe parashikimet kushtetuese të legjisllacionit aktual në fuqi, si dhe ligjin “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë të Republikës së Shqipërisë”.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij ligji, Presidenti i Republikës ka arritur në përfundimin se ligji nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë” bie ndesh me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, cenon autonominë e institucioneve të arsimit të lartë, cenon kompetencat e Presidentit të Republikës dhe nuk është në harmoni me kuadrin ligjor ekzistues të Republikës së Shqipërisë.

Presidenti i Republikës konstaton se parashikimet e pikës 1, të nenit 3 të ligjit nr. 53/2019, nuk janë në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ndryshe nga ligji nr. 80/2015, në ligjin nr. 53/2019 parashikohet se Akademië së Shkencave të Republikës së Shqipërisë i jepet një status më i lartë në hierarkinë e kërkimit shkencor. Kjo është e dukshme jo vetëm në pikën 1 të nenit 3 të ligjit të sapomiratuar, por edhe në dispozitat e tjera të tij. Konkretisht, në nenin 4, pika 9 të ligjit, vihet në dukje se Akademia e Shkencave bashkëpunon me institucionet e vendit me kapacitet kërkimi, si institucionet e arsimit të lartë, institutet dhe qendrat e kërkimit me qëllim koordinimin e kërkimit shkencor dhe përgatitjen e kërkuesve të rinj. Kjo dispozitë është pothuajse në të njëjtën frymë me parashikimet

e ligjit nr. 80/2015, por nëse krahasojmë pikën 1, të nenit 3 me pikën 6, të nenit 9 të ligjit nr. 53/2019, duket qartë se Akademisë së Shkencave dhe anëtarëve të saj u jepet një rol jo vetëm koordinues, por edhe mbikëqyrës ndaj veprimtarisë shkencore të institucioneve të arsimit të lartë.

Nëse qëllimi i ligjvënësit është që i gjithë procesi i kërkimit shkencor të udhëhiqet nga Akademia e Shkencave, atëherë ai duhet të zyrtarizohet në mënyrë të njëjtë me ligjin nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave”, ashtu edhe në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë”, në mënyrë që këto dy ligje të jenë plotësisht në harmoni me njëra-tjetrën dhe të mos sjellin në praktikë interpretime për rolin, veprimtarinë apo produktet që dy institucionet autonome si Akademia e Shkencave dhe institucionet e arsimit të lartë kanë apo realizojnë. Përcaktimi se Akademia e Shkencave është institucion publik më i lartë që mbart vlera më të mira të kërkimit shkencor, duhet të ishte i shoqëruar, gjithashtu, edhe me parashikime të qarta në ligj se këto institucione autonome punojnë dhe koordinohen mes tyre me qëllim bashkërendimin, zhvillimin, organizimin dhe administrimin e veprimtarisë kërkimore shkencore.

Parashikimet e pikës 3, të nenit 4, të ligjit 53/2019, ku parashikohet roli i Akademisë së Shkencave në ndërtim të strategjive dhe zbatimit të politikave për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe zyrtare, të terminologjive bashkëkohore të shkencës dhe teknikës, si dhe për konsolidimin e gjuhës shqipe në të gjitha fushat e shkencës, duhet të rivlerësohen edhe një herë nga Kuvendi.

Akademia e Shkencave nuk duhet të jetë e vetme për të realizuar një proces vendimmarrës kaq madhor në drejtimin e gjuhës shqipe, pa përfshirë brenda këtij procesi edhe katedrat përbërëse të fakulteteve të gjuhës, shkencave sociale, gazetarisë e të tjera, të cilat mund të kenë propozime konkrete për problematika konkrete lidhur me përdorimin e gjuhës shqipe.

Duke përshëndetur propozuesit dhe të gjithë ata që kanë kontribuar për ligjin, vlen të theksohet fakti se me përbërjen aktuale të këtij institucioni dhe në kushtet kur as e ardhmja nuk mund të jetë e parashikuar, Akademia e Shkencave nuk mundet, në fakt, nuk do të duhej të trajtonte e vetme problematikat delikate të përshtatjes, unifikimit dhe ndryshimit të simbolit kryesor të identitetit të kombit tonë, me ndryshime të vullshme që jeta ka sjellë që nga kongresi i fundit gjuhësor, i mbajtur në vitin 1972.

Trajtimi dhe vendimmarrja e problematikave lidhur me gjuhën shqipe dalin përtej kufijve dhe vullnetit të veprimtarisë individuale të Akademisë së Shkencave dhe duhen trajtuar në një rrafsh më gjithëpërfshirës, me qëllim që të gjithë bashkëkombësit tanë, e veçanërisht gjuhëtarët, të mund të përfaqësohen, të dëgjohen, si dhe të jenë pjesë e vendimmarrjes së unifikimit.

Është e nevojshme që në këtë proces të përfshihen të gjitha institucionet që kanë vlerë, ndaj për zbatimin e strategjive dhe politikave në këtë drejtim, duhet marrë më parë vendimi dhe vullneti i shprehur i Kuvendit të Shqipërisë.

Për këto arsye, Presidenti i Republikës vlerëson se parashikimet e pikës 3 të nenit 4, të ligjit nr. 53/2019 duhet të rivlerësohen edhe një herë nga Kuvendi.

Së treti, pika 7 e nenit 4 të ligjit nr. 53/2019 nuk është në harmoni me parashikimet e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, pasi krijon një mbivendosje në këtë funksion të ri të Akademisë, duke krijuar një përplasje me kompetencat e saj, me ato të institucioneve të arsimit të lartë. Institucionet e arsimit të lartë do të humbasin autonominë e tyre përballë Akademisë së Shkencave, ndërkohë që sipas parashikimeve të nenit 57, pika 7, të Kushtetutës, autonomia e institucioneve të arsimit të lartë dhe liria akademike janë të garantuara me ligj.

Pika 7 e nenit 4 i jep Akademisë së Shkencave një rol më të lartë autoriteti përkundrejt institucioneve të arsimit të lartë, duke bërë që këto parashikime jo vetëm të mos jenë në harmoni me ligjin nr. 80/2015, por të bien në kundërshtim edhe me parashikimet e Kushtetutës për sa i takon autonomisë së veçantë që gëzojnë këto institucione.

Së katërti, prekja e autonomisë, krijimi i një trajtimi të dyfishtë dhe përplasje e ligjeve, pika 14, e nenit 4, të ligjit nr. 53/2019, nuk është në harmoni me parashikimet e ligjit nr. 80/2015. Nga krahasimi i dispozitave midis dy ligjeve duket qartë se Kuvendi me parashikimet për rolin dhe funksionet kryesore që i ka dhënë Akademisë së Shkencave në nenin 4, pika 14, ka parashikuar kompetenca që tashmë janë të sanksionuara në ligj për institucionet e arsimit të lartë, duke prekur kështu autonominë e këtyre institucioneve edhe në fushën e trajtimit dhe zhvillimit të doktoraturës. Për rrjedhojë, kjo situatë ligjore krijon një trajtim ligjor të dyfishtë, duke përplasur ligjet midis tyre në mënyrë aspak të nevojshme për t’u rregulluar ndryshe.

Së pesti, pika 3 e nenit 6 të ligjit nr. 53/2019 bie në kundërshtim me vetë frymën dhe përcaktimet e ligjit të Akademisë së Shkencave, si dhe me parimet e Kushtetutës për ndalimin e çdo lloj diskriminimi.

Institucionet e kërkimit shkencor në Shqipëri, sikurse edhe Akademia e Shkencave kanë për detyrë të afrojnë dhe bashkëpunojnë me të gjithë kërkuesit shkencorë dhe shkencëtarët me origjinë shqiptare ose me shtetësi shqiptare, që ndodhen në rajon apo kudo në botë.

Për realizimin e këtij misioni kaq të rëndësishëm kombëtar me vlera të veçanta për kulturën dhe shkencën shqiptare, duhen gjetur forma dhe mekanizma që janë në përputhje me parimet e Kushtetutës dhe në harmoni me legjislacionin.

Marrja e statusit “Anëtari i jashtëm i Akademisë së Shkencave” vetëm për shkak të origjinës ose përkatësisë etnike shqiptare të një anëtari të një akademie shkencash në një vend tjetër, duhet të respektojë atë çka ligji i Akademisë së Shkencave ka në themel të parimit të anëtarëve të saj, pra kandidimin e lirë të çdo personi që paraqet këtë kërkesë.

Parimi i kandidatëve prezumohet se kryhet individualisht dhe jo në grup, shqyrtohet nga asambleja rast pas rasti mbi bazën e kriterëve jodiskriminuese pozitive ose negative, me karakter etnik për secilin kandidat të paraqitur.

Në këtë parashikim të dispozitës nuk jemi vetëm në kushtet e diskriminimit, por edhe të cenimit të vullnetit të individit, i cili duhet patjetër ta shprehë atë edhe në rastin e integritetit dhe ndërtimit, që i bie me përfshirjen e strukturave të një institucioni të rëndësishme së veçantë, siç është Akademia e Shkencave.

Arrihet në konkluzionin se e drejta për të qenë vendimmarrës dhe kontribues në veprimtarinë e Akademisë së Shkencave u takon si anëtarëve të zgjedhur, edhe anëtarëve automatikisht të pranuar, duke e thelluar më tej pozitën diskriminuese midis kategorive, në kushtet kur të parët janë pjesë përmes procesit të zgjedhjes, ndërsa të dytët, nga statusi i anëtarit të Akademisë që mbajnë një akademi pjesëtare të *All European Academies*.

Së gjashti, pika 1 e nenit 15 të ligjit nr. 53/2019 bie ndesh me formulime të tjera të vetë këtij ligji dhe krijon premisa të plota për diskriminim në barazinë e shanseve dhe në të drejtat e qytetarëve për arsye moshe, çka ndalohet kategorikisht si nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ashtu edhe nga ana e Kodit të Punës.

Në pikën 1 të nenit 15 parashikohet se anëtarë të asamblesë mund të zgjidhen personat deri në moshën 68 vjeç për titullin “akademik”, dhe deri në 65 për titullin “akademik i asociuar”.

Ky formulim nuk ka asnjë koherencë juridike, ku, nga njëra anë, vendosen kufizime për arsye moshe për kandidatët që kërkojnë të hyjnë në Asamblenë e Akademisë së Shkencave dhe, nga ana tjetër, vetë ligji për Akademinë e Shkencave në nenin 6, pika 4, përcakton qartazi se një anëtar i asamblesë, vetëm me mbushjen e moshës 75 vjeç merr titullin “Anëtar Emeritus”.

Në këtë mënyrë, përveç mungesës së koherencës logjike midis dy normave, brenda këtij ligji krijohet, gjithashtu, edhe një situatë e pastër diskriminuese midis individëve që janë tashmë

anëtarë të asamblesë dhe individëve që dëshirojnë të kandidojnë për t'u bërë anëtarë të saj, duke bërë që kjo pikë e nenit 15 të ligjit nr. 53/2019 të bjerë ndesh me parashikimet e nenit 18 të Kushtetutës dhe nenit 14 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Së shtati, pika 1 e nenit 9 të këtij ligji objekt shqyrtimi, krijon paqartësi normative për statusin, funksionet dhe rolin e Akademisë së Shkencave. Ka një paqartësi juridike për sa i përket rolit dhe funksioneve të vetë Akademisë së Shkencave në lidhje me ngritjen e njësive të kërkimit të studimit dhe aktiviteteve afatshkurtër/afatgjatë. Ai nuk përcakton se çfarë do të thotë “afatgjatë”. Duke mos iu vendosur kufizime kohore njësive të kërkimit, krijohet mundësia që ato të jenë të përhershme.

Gjithashtu, për njësitë e kërkimit afatshkurtër që kufizohen me një veprimtari deri në 2 vjet, nuk përcaktohet nëse ato mund të transformohen ose t'u ripërtërihet mandate, duke u bërë praktikisht afatgjata. Ndaj, ndarja në njësi kërkimi afatgjatë dhe afatshkurtër nuk e zgjidh juridikisht edhe përcaktueshmërinë e krijuar lidhur me atë se kush e ka tagrin për të themeluar këto njësi kërkimi, gjë që në ligjin për arsimin dhe kërkimin shkencor analogjikisht e drejta e hapjes pas propozimit të IAL-ve i jepet ministrisë që mbulon fushën përkatëse dhe Këshillit të Ministrave.

Në kushtet kur kërkimi shkencor gjendet aktualisht i rregulluar me ligjin nr. 80/2015, rrezikohet krijimi i institucioneve kërkimore shkencore paralele me ato që janë jashtë sistemit të Akademisë së Shkencave, ndaj nevojitet përcaktimi dhe qartësimi i rolit të Akademisë në sistemin e kërkimit shkencor në Shqipëri.

Kështu, krijimi i kuadrit juridik të të gjithë sistemit të kërkimit shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe, më pas, përcaktimi ligjërish i rolit dhe funksioneve të Akademisë së Shkencave brenda këtij sistemi do të ishin thelbësorë edhe për mirorientimin dhe dedikimin e fondeve të buxhetit të shtetit.

Së teti, pikat 5 dhe 6 të nenit 11, të ligjit nr. 53/2019, bien në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe cenon kompetencat e Presidentit të Republikës.

Kushtetuta nuk ka vendosur një afat të përcaktuar, brenda të cilit Presidenti i Republikës duhet të shprehet apo për ndonjë pasojë që mund të vijë nga mosshprehja me akt të vullnetit të tij në procesin e emërimit të kryetarit të Akademisë së Shkencave.

Ndërsa parashikimi i pikës 5 të nenit 11, të ligjit nr. 53/2019, synon vendosjen e një afati 10-ditor, brenda të cilit Presidenti i Republikës duhet të kryejë emërimin e kryetarit.

Gjithashtu, pika 6 e po këtij neni ka parashikuar një mekanizëm që nuk ekziston në Kushtetutë, për më tepër që kushtetutëbërësi as nuk e ka pasur qëllim ta vendosë atë në parashikimet e aktit themeltar të shtetit.

Edhe në variantin fillestar të projektligjit të depozituar në Kuvend nga deputetët nismëtarë më 03.04.2019 parashikimet e projektligjit të paraqitur nuk përmbanin këto rregulla ligjore me natyrë kufizuese të kompetencave të Presidentit të Republikës.

Nga shqyrtimi i praktikës parlamentare të projektligjit, nuk arrihet të kuptohet se cila ka qenë arsyeja dhe cili ka qenë qëllimi i ndërhyrjes me ligj në këtë nivel antikushtetutshmërie.

Nisur nga fakti që ky projektligj është shqyrtuar nga Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në mbledhjet e datave 9, 10, 11, 15 dhe 16 korrik 2019, është e qartë që të gjitha reflektimet e mëvonshme të këtij komisioni, por dhe më pas të Kuvendit në seancën plenare të datës 18.07.2019, janë bërë në mënyrë subjektive dhe krejt të pambështetura, duke iu referuar faktit që gjatë periudhës që projektligji po shqyrtohej në komisionin parlamentar, Presidenti i Republikës, në ushtrim të kompetencave të tij, me dekretin nr. 11223, datë 11.07.2019, ka refuzuar emërimin e akademikut Skënder Gjinushi, si kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë.

Parashikimet e pikave 5 e 6 të nenit 11 të ligjit nr. 53/2019 në thelb i kufizojnë kompetencat e Presidentit të Republikës. Për më tepër, referuar përmbajtjes së këtyre parashikimeve të ligjit, Kuvendi, në mënyrë krejtësisht të gabuar, bën një përmbysje të autoritetit dhe rolit të organeve kushtetuese në Republikën e Shqipërisë, dhe nuk gjen asnjë mbështetje në Kushtetutën e vendit apo në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese.

Nuk mundet që një organ i Akademisë së Shkencave të shqyrtojë dhe të shprehet me vendim për dekretet e Presidentit të Republikës, pasi kjo nuk është e parashikuar në Kushtetutë. Afatet dhe mekanizmat zhblllokues të proceseve në rastet e përcaktuara duhet të vendosen në Kushtetutë.

Kushtetuta nuk e parashikon procesin e emërimit të kryetarit të Akademisë së Shkencave; nuk parashikon as afate, as mekanizma zhblllokues dhe as institucione të tjera që mund të marrin vendime për dekretet e Presidentit të Republikës për këtë çështje.

Kjo nuk është harresë e kushtetutëbërësit, por një vullnet i shprehur i tij, pasi dispozita e nenit 92/g është e njëjtë dhe pa ndryshime që nga miratimi i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në vitin 1998.

Sa më sipër, rezulton se atë, që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta, nuk mund ta bëjë ligji, duke përmbysur kështu edhe hierarkinë e akteve në Republikën e Shqipërisë.

Presidenti i Republikës është organi i emërtesës për emërimin e kryetarit të Akademisë së Shkencave dhe kjo kompetencë e kreut të shtetit kurrësi nuk mund të derivohet dhe as të kufizohet me një vendimarrje të dytë të ndonjë institucioni apo organi tjetër, kushdo qoftë ai.

Kjo kompetencë nuk mund të jetë në asnjë rast me karakter simbolik, por garantues i parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

Parashikimi i pikës 6 të nenit 11 të ligjit nr. 53/2019 mënjanon dhe tejkalon kompetencën e parashikuar shprehimisht në dispozitën kushtetuese, duke i dhënë përparësi një akti juridik me fuqi më të ulët. Për rrjedhojë, cenohet edhe parimi i shtetit të së drejtës, i shprehur në hierarkinë e normave dhe përparësinë e Kushtetutës, në raport me normat e tjera ligjore.

Në këto kushte, nëpërmjet parashikimeve të pikave 5 dhe 6 të nenit 11 të ligjit nr. 53/2019, gjendemi përpara situatës së shkeljes flagrante të Kushtetutës, sepse kemi të bëjmë me një kufizim të kompetencave të Presidentit të Republikës nëpërmjet një ligji, i cili është një akt me fuqi ligjore më të ulët se Kushtetuta dhe nuk mund të mbizotërojë mbi të.

Për gjithë sa u parashtruan më sipër, me qëllimin e vetëm përmirësimit të këtij ligji, në përputhje me parashikimet kushtetuese dhe respektimin e autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe në mënyrë që ky ligj i ri të jetë në harmoni me kuadrin ligjor ekzistues në Republikën e Shqipërisë, në bindje të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 85, pika 1, kam vendosur kthimin për rishqyrtim të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë”, me qëllim rishikimin dhe përmirësimit të pikës 1 të nenit 3, pikave 3, 7 dhe 14 të nenit 4, pikës 3 të nenit 6, pikave 5 dhe 6 të nenit 11, pikës 1 të nenit 15, si dhe pikës 1 të nenit 19.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Para se t’i jap fjalën relatorit, vë re që në sallë nuk janë të pranishëm deputetët iniciatorë të këtij projektligji.

Zoti Tole, cilët janë autorët e vërtetë të këtij projektligji? A është zoti Gjinushi, së bashku me ju, apo janë deputetët iniciatorë? Unë nuk mund ta kuptoj një gjë të tillë!

Zoti relator, fjala është për ju.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Nuk janë të pranishëm.

Po, urdhëroni!

Vilma Bello – Zonja kryetare, ju përshëndes!

Përshëndes edhe të ftuarit!

Unë jam një nga përfaqësueset e grupit nismëtar. Nëse në këtë seancë, ku po diskutojmë për dekretin e Presidentit për kthimin e projektligjit “Për Akademinë e Shkencave”, nuk është kërkuar të jenë këtu edhe përfaqësues të tjerë të grupit nismëtar, ne vazhdojmë dhe jemi në komunikim të vazhdueshëm me përfaqësuesin e Akademisë së Shkencave për të dëgjuar çdo gjë që ata mendojnë për kthimin e këtij projektligji.

Fatjona Dhimitri – Ndoshta procesi i deformuar që nga fillimi i hartimit të këtij projektligji, i cili u soll si fillim nga grupi i punës me në krye Skënder Gjinushin, u mor më tej nga grupi i nismëtarëve dhe u soll këtu si një iniciativë deputetësh, po sjell pikërisht procesin e dekonstruktimit të Akademisë së Shkencave.

Fjalën e ka relatori.

Milva Ekonomi – Dua të them diçka për kujtesë. Grupi i nismëtarëve që ka sjellë këtë projektligj, të cilin ne e shndërruam në ligj, ka të drejtë të propozojë dhe të marrë opinion edhe nga ekspertë të pavarur, që kryejnë aktivitetin e tyre në Republikën e Shqipërisë.

Zonja kryetare, mendoj se duhet të kemi pak respekt për punën që ka bërë grupi i nismëtarëve dhe për përfshirjen në hartimin e këtij projektligji edhe të ekspertëve që punojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Ju lutem, të bëjmë pak kujdes kur u drejtohem hartuesve të ligjeve në Republikën e Shqipërisë, sepse ne thërrasim shoqërinë civile, ekspertë të pavarur dhe institucione të ndryshme që japin mendime për një projektligj që hartohet. Ne kemi respekt për të gjithë ata që kontribuojnë në bërjen mirë të punës legjislative.

Fatjona Dhimitri – Ne thërrasim shoqëri civile, profesorë dhe rektorë, por mendimet e tyre nuk i marrim parasysh.

Zoti relator mund ta merrni fjalën.

Ismet Beqiraj – Ju mund të më ndërprisni përsëri.

Fatjona Dhimitri – Sa herë që të jetë e nevojshme.

Ismet Beqiraj – Ju mund të më ndërprisni, por jo me Rregullore.

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni.

Ismet Beqiraj – Përshëndetje të gjithëve!

Përshëndetje edhe medias!

Më vjen mirë që sot kemi një mbipopullim mediatik, për ta bërë edhe më të qartë ligjin e ri “Për Akademinë e Shkencave”, i cili synon të sjellë shkencën në politikë dhe jo politikën në shkencë.

Zonja kryetare, nuk duhet të intimidoni kolegët deputetë, por as medien me definicionet e vlerësimit që jepni.

Ju si drejtuese keni të drejtë ta drejtoni komisionin dhe të procedoni sipas Rregullores dhe, kur diskutoni, të jepni mendimet tuaja.

Përfaqësueses së Presidencës unë do t’i bëj disa pyetje rreth kontestimeve që ka bërë, pasi ky ligj është produkt i diskutimit të gjerë e të gjatë në kohë dhe në hapësirë brenda e jashtë vendit me institucione kërkimore shkencore, të cilat i kanë dhënë certifikimin e standardit europian, siç është ALLEA dhe Akademia e Shkencave gjermane “Leopoldina”.

Unë, si person që vij nga bota akademike, si pedagog i një universiteti në vend, nuk e prisja të ishte ky definicion nga Presidenca që në fillim: “Ky ligj bie ndesh me parashikimet e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, cenon kompetencat e Presidentit, cenon autonominë e institucioneve të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor, si dhe nuk është në harmoni me kuadrin ligjor ekzistues të Republikës së Shqipërisë”. Ky është definicioni i gjithë konkluzioneve që na jepet që në fillim.

Pyetja ime e parë është: në argumentet tuaja si institucion, a e keni marrë në konsideratë vlerësimin dhe ekspertizën e gjatë që i është bërë këtij ligji, të cilat nuk i janë bërë në kornizë, por nen për nen dhe germë për germë nga ekspertë të shquar të shoqatës së akademive europiane ose nga ALLEA, të cilën edhe ju e përmendët, si dhe nga ata të Akademisë gjermane “Leopoldina”?

Pyetja e dytë ka të bëjë me parashikimet e pikës 1 të nenit 3, që lidhen me Akademinë, ku shprehimisht thuhet: “Akademia është një institucion publik më i lartë, që përfaqëson dhe mbart vlerat më të mira të shkencës, kërkimit shkencor, krijimtarisë, debatit dhe bashkëpunimit të mendimit shkencor në vend përmes një bashkësie të zgjedhurish shkencëtarësh dhe krijuesish”. Këtu me keqdashje futet edhe te kërkimi shkencor. Nëse Akademia e Shkencave nuk do të kishte si objektiv kërkimin shkencor dhe promovimin e shkencëtarëve të rinj që nga studentët, ata me titullin “master”, “doktor shkencash”, “profesor asistent” dhe “profesor”, pastaj do të merrnin gradat akademike, si “akademik i asociuar” dhe “akademik”, përse do ta quajmë dhe të ngrihet si institucion i pagëzuar kudo nëpër botë Akademia e Shkencave?

E treta, mos vallë kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë dhe kudo e kanë monopol vetëm institucionet e arsimit të lartë publik? Është ligji nr. 80/2015. Po institucionet e arsimit të lartë jopublik? Po institucionet e kërkimit dhe prodhimit në fushën e tregut të industrisë? Po individë të caktuar, nuk kanë të drejtë të bëjnë kërkim shkencor? Këtu paska një mbivendosje sikur Akademia e Shkencave merr të drejtën dhe monopolin! Nuk e shikoj gjëkund.

Në vazhdim, meqenëse jeni futur dhe e keni zgjeruar këtë pikë, për të sjellë argumente, a mund të ekzistojnë institucionet e arsimit të lartë pa komponentin bazë, që është në kurrikul, për kërkimin shkencor, sepse që aty fillon!?

Akademiku i nderuar kosovar, Nexhat Daci, në një takim me komisionin, është shprehur: “Institucionet e arsimit të lartë janë toka prodhuese, ku furnizohen akademitë”. Mos vallë pika 3 e nenit 94 të ligjit nr. 85 të vitit 2015 “Për institucionet e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor” i hedh poshtë të gjitha argumentet tuaja për mosqëndrimin në harmoni me dispozitat e ligjit nr. 80, të vitit 2015, pikat 1 dhe 3, me ligjin nr. 53 të vitit 2019? Konkretisht, në pikën 3 të nenit 94 të ligjit për arsimin e lartë “Strukturat e kërkimit shkencor” thuhet: “Kërkimi shkencor zhvillohet dhe organizohet edhe në institucione të tjera, veprimtaria e të cilave rregullohet me ligj të veçantë”. Pra, Akademia e Shkencave, si një institucion i tillë, e organizon, nuk e ndalon. Kjo e rrëzon të gjithë argumentin.

Nga ana tjetër, mund të përjashtohet roli ombrellë për bashkëpunimin e Akademisë së Shkencave me të gjitha institucionet shkencore dhe institucionet e arsimit të lartë. Këtu do të sjell në parantezë pikën 2 të nenit 6 të ligjit që kemi miratuar, ku Akademia e Shkencave i hap të gjitha dyert për të marrë pjesë, si në procedura, në kritere dhe në përzgjedhjen e drejtuesve të institucioneve të arsimit të lartë dhe të kërkimit shkencor.

Nga ana tjetër, u bë një zhurmë e madhe që institucionet e arsimit të lartë po trysnohen, po kufizohen dhe po u hiqet autonomia.

Neni 18 ka të bëjë me bashkëpunimin, çka është një nga risitë e mëdha me të cilën ky ligj e hap Akademinë e Shkencave, nuk e ka të fosilizuar në struktura drejt kërkimit shkencor, drejt institucioneve prestigjioze. Në pikën 2 të nenit 18 thuhet: “Në përbërje të komisioneve ka si anëtarë, përveç akademikëve, edhe përfaqësues të institucioneve dhe të qendrave të kërkimit shkencor, të cilët nuk janë pjesë e asamblesë, qoftë me statusin “akademik i asociuar”, qoftë edhe “akademik”. Dera tjetër, për të mos thënë autostrada, që hapet nëpërmjet këtij ligji, është pika 2 e nenit 21, ku thuhet: “Në mbledhjet e saj vjetore për miratimin e programit të punës së Akademisë,

ftohen të marrin pjesë përfaqësues të institucioneve kryesore”. Pra, Akademia e Shkencave i konsideron këto bashkëpunime jo vetëm ura të fuqishme bashkëpunimi me këto institucione, por edhe si oksigjen për zhvillimin dhe gjallimin e shkencës dhe funksionimin e institucioneve që bartin këtë veprimtari në vendin tonë.

Për sa i përket pikës 2, sipas saj parashikimet e pikës 3 të nenit 4 të ligjit nr. 50/2019 duhet të rivlerësohen edhe një herë. Pra, në këtë pikë thuhet: “Të ndërtojë strategji dhe të zbatojë politika për përdorimin e njehësuar të gjuhës shqipe zyrtare, të terminologjive bashkëkohore, të shkencës dhe të teknikës, si dhe të konsolidohet gjuha shqipe në të gjitha fushat e shkencës”. Me të drejtë pyetja ime është: Akademia e Shkencave, që në gjenezën e saj në vendin tonë, e ka kryer këtë rol historik, apo nuk e ka kryer dhe a duhet ta kryejë? A ua ka privuar institucioneve të tjera? Ne kemi Akademinë e Shkencave të Albanologjisë, që është simotër. Nuk duhet ta ketë këtë? Kjo është një nga detyrat kryesore për të mbrojtur identitetin tonë kombëtar.

Për sa i përket pikës 7 të neni 4, që ka të bëjë me rolin dhe funksionet kryesore të Akademisë, thuhet se nuk është në harmoni me parashikimet e ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”. Përfaqësuesit e Ministrisë së Arsimit kanë qenë rojtarët më të rreptë për të mos lejuar mbivendosje gjatë diskutimit, kalimit nen për nen dhe deri në korrigjimet e fundit të ligjit, që ne çuam në seancë dhe që sot është i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.

Unë do të pyesja, sepse te neni 7 dilet edhe me definicionin tjetër, kur thuhet: “Të promovojë, të botojë dhe të shpërndajë standardet e reja ndërkombëtare të kërkimit shkencor dhe të inovacionit, të garantojë respektimin e tyre për vlerësimin e punës shkencore dhe të etikës në shkencë, si dhe të mbështesë programin e studimit apo të kërkimit”, pra këtë rol nuk mund ta luajë Akademia e Shkencave, ku produkti i saj nuk është i detyrueshëm, por alternativë, si një organ garanti për respektimin e standardeve në fushën e kërkimit shkencor, si dhe në hartimin e raporteve vlerësuese në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse për arsimin dhe shkencën. Ku qëndron karakteri urdhërues dhe detyrues i këtij institucioni?

Lidhur me pikën 14 të nenit 4, për rolin dhe funksionet kryesore të Akademisë, ku thuhet: “Të orientojë fushat dhe nënfushat parësore në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shkencën, për kërkimin shkencor, doktoratën, të analizojë arritjet dhe problematikat e këtyre kërkimeve dhe të hartojë në çdo 2 vjet një raport publik për këto”, a mund t’i mohohet roli këshillimor dhe relatues Akademisë së Shkencave për ministrinë përgjegjëse për Shkencën si

politikëbërëse që është kjo e fundit? Nuk ka të drejtë ministria që të kërkojë raporte, ekspertiza dhe analiza?

Lidhur me pikën 3 të nenit 6, ku thuhet: “Bie në kundërshtim me vetë frymën dhe përcaktimin e ligjit “Për Akademinë e Shkencave”, si dhe me parimet kushtetuese për ndalimin e çdolloj diskriminimi për arsye të origjinës ose përkatësisë etnike”, kam një pyetje. Deri tani me ligjet që kanë qenë në fuqi, janë ndryshuar disa herë, që nga ligji i famshëm i vitit 2006 dhe më pas, Akademia e Shkencave gati nuk arrinte të bënte zgjedhje, por me këtë ligj dhe me këtë nen me mënyrën e zgjedhjes, jo vetëm me anëtarët e përhershëm, por me anëtarët e nderit, me anëtarët korrespondentë, me anëtarët e jashtëm, me Akademinë e të Rinjve, Akademia e Shkencave hapet, shpërthehet struktura që ishte kthyer në një guaskë të fosilizuar. Pikën 3 të nenit 6, e konsideroni hapje apo mbyllje të Akademisë së Shkencave? Ku qëndron diskriminimi, sepse aty përcaktohet saktësisht?

Pika 1 e nenit 15 bie ndesh me formulime të tjera të këtij ligji dhe krijon premisa të plota për diskriminimin në barazinë e shanseve dhe të drejtave qytetare, për arsye moshe, gjë që ndodhet në kategoritë, si në Kushtetutën e Republikës. Problemi është i tillë, që anëtarëve të Akademisë u janë vendosur kufij maksimalë të së drejtës për t’u anëtarësuar “anëtar i asociuar” dhe “akademik i përhershëm”. Këto kufizime që do t’i quaja pozitive, pse janë diskriminuese, kur këto kufizime janë në të gjitha aktet ligjore të akademive të shkencave të tjera të botës dhe të ALLEA-s, ku ne jemi anëtarë? Ka një arsye. Jo për ko incidencë, se ishte një propozim tjetër nga 60 vjeç në 65 në draftin final. Komisioni gjatë diskutimit të gjerë dhe parlamenti që e miratoi në fund, e çoi në kufijtë e përfundimit të ciklit të detyrueshëm ligjor të aktivitetit mësimdhënës dhe shkencor të trupës akademike në 65 vjeç dhe 68 vjeç; nëse thotë deri në 65 vjeç, ai që bën një zbulim, një kërkim shkencor, ta gëzojë edhe 35 vjeç, edhe 40 vjeç, edhe 45 vjeç. Nuk ka kufizim dysHEME, por kufizim tavan ka. Unë jam pedagog, dal 65 vjeç në pension, nuk dua të vazhdoj më si pedagog i brendshëm, por komponentin e kërkimit shkencor nuk e kam detyrim, siç e ka ai që është definitiv. Kjo gjë është bërë, por nuk është diskriminim. Po në vendet e BE-së, ku duam të shkojmë, diskriminohen ata?

Lidhur me një pikë tjetër, pra që pika 1 e nenit 19 krijon paqartësi normative për statusin, funksionet dhe rolin e Akademisë së Shkencave, ligji përcakton shinat, autostradën ku do të ecet, rregulloren, statutet, janë hyrjet, daljet, rregullimi në tërësi i të gjithë infrastrukturës ligjore që funksionon në një institucion.

E dini ku është merakuri këtu? Tek e drejta, te struktura përbërëse, e cila është një nga risitë që përmbysnin organizimin e Akademisë së Shkencave deri para 18 qershorit, sepse u hoq e drejta e krijimit të njësive të kërkim-studimit. E me këtë është futur elementi i kërkim-studimit. Nuk mund t'ia heqim Akademisë së Shkencave dhe cilitdo institucion tjetër të drejtën që t'i krijojnë këto. Sepse, fatkeqësisht, me ligjin që ishte në fuqi u shkatërruan të gjitha institucionet që ishin vlerë intelektuale, disa dekada. Unë e kam përmendur dhe do ta përmend: është bërë një krim shkencor.

Po marr një rast konkret: shkatërrimin e instituteve të naftës. Kanë qenë tre institute. Përdërisa kemi pasuri natyrore, kush do ta bëjë ekspertizën, kush do ta bëjë monitorimin e kompanive publike, e kompanive që e kanë marrë me koncesion, atyre private? A do ta zhvillojmë vendin? Për të mos folur pastaj për institutet e tjera në të gjithë Shqipërinë.

Më vjen keq që kjo frymë negativiteti ka gjetur strehë edhe në Presidencë. Është bërë zhurmë e madhe: si do të ngrihen këto, do të ketë financa apo jo? Po more! Është parashikuar te dispozitat transitorë se si do të funksionojë. Kuvendi do t'i miratojë në buxhet fondin, organigramën e gjitha të tjerat. Ne bëjmë thirrje që të gjithë që të ngrihen sa më shpejt këto institucione të kërkimit, për ta zhvilluar Shqipërinë. Se po më kujtohet ajo shprehja e famshme e të ndjerit dhe e të respektuarit Sabri Godo: “Jo pesëdhjetë për qind të shërbejnë dhe pesëdhjetë për qind të pinë kafe”. Le të kthehemi nga prodhimi, me të gjithë elementët, e të hapim vende pune, të vemë në eficiencë kapitalet tona. Se nuk bën pa shkencë, pa mendja, pa tru! Ky është shekulli i mendjes, nuk është shekulli i luftës për karrige.

Ju faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Po, zoti Ismet, por problemi qëndron në faktin nëse ky ligj ka mbivendosje me ligjin “Për arsimin e lartë” apo jo, ka shkelje apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Kemi përfaqësuesin e Ministrisë së Arsimit...

Ismet Beqiraj – Ju lutem! E para, nuk pres përgjigje nga ju, se e di përgjigjen. Të lutem, mos më bëj më pyetje. S'ke të drejtë të më bësh pyetje, se as unë s'kam të drejtë të të bëj pyetje.

Fatjona Dhimitri – Pyetjet ua dërgoj ekspertëve unë, Ismet.

Ismet Beqiraj – Unë pres përgjigje nga paneli i nderuar, që është këtu.

Fatjona Dhimitri – Përgjigjet i ke në ligjin tënd, Ismet, në ligjin që keni sjellë ju. Kemi mbivendosje kompetencash. Ose nuk e ke lexuar ti, ose e ke draftuar ashtu siç të intereson ty.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – A mund të dëgjojmë ekspertët që kemi thirrur këtu, përpara se të japim opinione, kryetare?

Fatjona Dhimitri – Zoti Tola, keni një mendim lidhur me dekretin e Presidentit? E keni depozituar me shkrim pranë komisionit tonë?

Erzen Tola – Përshëndetje, e nderuara kryetare!

Të nderuar anëtarë të komisionit!

Sikurse jeni në dijeni, ligji nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë” është propozim i një grupi deputetësh, ndërkohë që Këshilli i Ministrave, sipas kërkesës së Komisionit të Edukimit dhe Medias, me vendimin nr 392, datë 19. 6. 2019, ka dhënë opinionin e tij për projektligjin dhe Ministria e Arsimit është shprehur nëpërmjet opinionit të dhënë nga Këshilli i Ministrave.

Ministria e Arsimit i mbetet opinionit të Këshillit të Ministrave, i cili është marrë pothuajse i tëri në konsideratë nga ana e komisionit, gjatë shqyrtimit të projektligjit, në fazën e shqyrtimit në komision.

Konstatojmë se nenet që janë dhënë, në opinionin e Këshillit të Ministrave nuk lidhen me nenet e me pikat e diskutuara nga dekreti i Presidentit. Për sa më sipër, ne i mbetemi projektligjit që është diskutuar dhe miratuar.

Fatjona Dhimitri – Që në fillim projektligji ka pasur deformim, sikundër e thashë, i mungonte raporti financiar. Ju e dini shumë mirë këtë gjë.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi – Raporti financiar, sipas asaj që ne kërkuam, na erdhi nga Akademia e Shkencave. Nuk e keni ndjekur...

Fatjona Dhimitri – Duket se nuk është marrë parasysh ashtu siç duhet në draftimin përfundimtar.

Milva Ekonomi – Të lutem, shikoji të gjitha dokumentet që janë në dosje e pastaj shprehu, sepse aty e ke.

Fatjona Dhimitri – I kam parë. Në qoftë se përfaqësuesi i Presidencës dëshiron të shprehet.

Krisilda Fana – Zonja kryetare, ajo që desha të thosha për relatorin, është se në të gjitha përgjigjet e pyetjeve të ngritura, qoftë në arsyetimin që relatova me gojë, qoftë në arsyet e dekretit

të bashkëlidhur... Më vjen keq që zoti relator iu referua vetëm pikave nga 1 deri në 7 dhe nuk ngriti asnjë shqetësim, dhe nuk shprehu diçka edhe për pikën 8, ku ne kemi arsyetuar se ka të bëjë me kufizimin e kompetencës së Presidentit.

Për të tjerat, nuk kam çfarë them, se i kemi arsyetuar me shkrim, i kanë të gjithë deputetët, besoj, ndërsa opinionin publik mund t'i gjejë edhe në faqen e internetit. Unë u shpreha edhe më parë me gojë. Ndoshta do të duhej të kisha folur pas relatorit.

Fatjona Dhimitri – Të pranishëm në sallë janë ekspertët e Kushtetutës, për të na shpjeguar nëse kemi tejkalim të kompetencave të Presidentit apo jo.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Juristi ose këshilltari ligjor, nëse e do fjalën. Kemi apo jo tejkalim të kompetencave të Presidentit?

Ismet Beqiraj – Për procedurë, a mundem?

Fatjona Dhimitri – Jo, një minutë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Ismet Beqiraj – Të lutem, për procedurë.

Fatjona Dhimitri – Po, mund të flasësh.

Ismet Beqiraj – Kemi filluar me pyetjet. Zonja ose zonjusha, ua ktheu si ua ktheu përgjigjet pyetjeve të mia, tjetër gjë nëse më pëlqejnë mua...

Fatjona Dhimitri – Po ti nuk je ekspert i Kushtetutës, për të na thënë neve nëse është shkelur Kushtetuta apo jo!

Ismet Beqiraj – Të lutem! Edhe në lidhje me këtë, nuk e kam vetëm unë monopolin për të bërë pyetje, por të gjitha palët, pozitë e opozitë, ndaj do të të lutesha: vazhdo me procedurën ligjore dhe me zbatimin e Rregullores, vazhdo me pyetjet. Pastaj bëj diskutimin, thirr këshilltarin e komisionit dhe këshilltarë të jashtëm...

Fatjona Dhimitri – Jo, ju thoni kështu: në qoftë se Presidenti nuk e dekreton kryetarin e Akademisë së Shkencave, ai vetëshpallet.

Ismet Beqiraj – Të lutem!

Fatjona Dhimitri – Kështu thoni ju: hajt ta vetëshpallim ne një ish-ministër diktature!

Ismet Beqiraj – Të lutem, të lutem! E ke të shkruar ndokund në Rregullore, që relatori sot do pyesë për të gjithë dhe të gjithë anëtarët e komisionit do të heshtin? E ke në Rregullore? Unë kaq thashë. Unë iu përgjigja vetëm dy-tre kontestimeve. Një pikë e vetme.

Fatjona Dhimitri – Atëherë merrni parasysh vërejtjet e Presidentit dhe theksoni nëse ka shkelje apo jo.

Ismet Beqiraj – Sigurisht që i kam marrë.

Fatjona Dhimitri – Kemi apo jo shkelje, kemi apo jo mbivendosje të ligjit “Për arsimin e lartë”? Kemi apo jo diskriminim lidhur me anëtarët e jashtëm të asamblesë?

Ismet Beqiraj – Ju lutem, mos më bëni ju pyetje, se jemi në pozita të barabarta si deputetë!

Fatjona Dhimitri – A je relator ti këtui? Është ligji juaj. Nuk e kam sjellë unë këtë ligj, por e keni sjellë vetë...

Ismet Beqiraj – Të lutem, e di Rregulloren apo s’e di?

Të lutem, nuk jam unë hartues i ligjit, unë jam si ju.

Fatjona Dhimitri - A ka pyetje për grupin e ekspertëve?

Milva Ekonomi - Unë mendoj se duhet t’ia japim fjalën zotit Tole, pastaj të vazhdojmë me pyetjet, në mënyrë që të kemi në kohë të gjitha përgjigjet dhe të gjitha vërejtjet që kemi për të kuptuar më mirë situatën. Nuk e di nëse jeni dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Zoti Tole, fjala për ju!

Vasil Tole – Faleminderit!

Të nderuar kolegë deputetë, lidhur me këtë takim, mendimet tona si institucion për çdo pikë të kontestuar nga dekreti i Presidentit të Republikës i kemi dërguar zyrtarisht pranë komisionit përmes praktikës shkresore. Ajo që dua t’ju them, para se të kaloj në një përshkrim të përmbledhur të pikave të kontestuara dhe argumenteve tona, është se për ne të gjitha çështjet që diskutohen nuk janë të reja, pasi, siç u përmend nga relatori dhe nga përfaqësuesi i Ministrisë së Arsimit, është bërë një punë e madhe për të arritur deri në miratimin e këtij ligji. Të gjitha çështjet janë të diskutuara dhe u është dhënë zgjidhje në kohën e duhur.

Për të hequr merakun e dikujt që mendon se Akademia e Shkencave përmes këtij ligji do të ketë një rol monopol përkundër institucioneve të tjera, më lejoni t’ju paraqes të përmbledhura një grupim fjalësh që ligji i jep Akademisë për të kryer: “Akademia koordinon, bashkëpunon, këshillon, boton, jep ekspertizë dhe propozon”. I vetmi rast kur në ligj ka një fjalë që mbaron me “os”, pra, që Akademia vendos, është pranimi i anëtarëve të saj. Në të gjitha rastet e tjera, kur flitet për uzurpim apo për shkelje të kompetencave të institucioneve të tjera, kryesisht të institucioneve të arsimit të lartë... Nëse institucioni i Presidentit do të gjente mundësinë që të konsultoheshim,

ndoshta ky dekret nuk do të dilte fare për këtë projektligj. Është keqkuptuar një gjë, që ne kemi një mision të përbashkët dhe secili bën punën e vet, pa i shkelur hapësirat e lirisë njeri-tjetrit. Thelbi i këtij ligji nuk është uzurpimi i kompetencave të institucioneve të tjera, por është hapja e Akademisë për të tjerët.

Në lidhje me çështjen e kufizimit të kompetencave të Presidentit, do e them pasi të bëj këtë parashkrim të shkurtër të qëndrimit tonë, duke i perifrazuar dhe duke dhënë mendimin tonë të thukët. Kontestohet pika 1 e nenit 3, sepse thuhet: “Akademia është institucioni publik më i lartë”, pra, ata kanë shqetësimin e fjalëve “më i lartë”. Këtu ngatërrohet diçka esenciale, ku të gjithë e keni kuptuar kështu, që ligji nuk i jep Akademisë një rol udhëheqës apo mbikëqyrës për hierarki vlerash dhe jo hierarki administrative që Akademia qëndron mbi të tjerët dhe i urdhëron, sepse në asnjë rast në ligj nuk ka një kompetencë të Akademisë që merr vendim Akademia dhe e zbatojnë institucionet e tjera. Një fakt i thjeshtë, i cili është pranuar edhe në ligjin e arsimit të lartë, është ajo që ne e quajmë hierarkia e titujve. Titulli “akademik” qëndron mbi titullin “profesor” dhe ky ligj bëhet për këtë hierarki dhe bashkësi shkencëtarësh, të cilët e gëzojnë këtë titull, por kjo nuk do të thotë që ne kemi hierarki administrative ose ekzekutime mbi institucionet e tjera, por kemi hierarki vlerash, ku pranojmë që janë 45 shkencëtarë, që janë doktorë, profesorë, por kanë titullin “akademik”, që organizohen në bazë të këtij ligji. Kjo është çështja e pikës së parë të nenit 3.

Pika 3 e nenit 4, flet për ndërtimin e strategjive dhe zbatimin e politikave për përdorimin e njësuar të gjuhës shqipe. Vini re: ka ndërtim strategjish, zbatim politikash, askund nuk ka urdhërim, pra këtë funksion ne nuk e kryejmë vetëm, por me të gjitha institucionet e tjera. Madje, aktualisht, kjo është mungesa e informacionit, që në këtë rast ka edhe institucioni i Presidentit, të vetmet organe autoritare për gjuhën shqipe janë ato që quhen këshilla ndërakademikë të gjuhës shqipe, që funksionojnë mes Akademisë së Shkencave të Shqipërisë dhe Akademisë së Shkencave të Arteve të Kosovës. Madje, vendimet që ata marrin, nuk zbatohen, në rast se ligjvënësi, Ministria e Arsimit, Komisioni i Kuvendit apo një organ tjetër, nuk i çmon ato që duhen marrë dhe t’i shndërrojë në udhëzime qeverie, në udhëzim ministri, në vendime qeverie, për më tepër, që ne synojmë nesër të kemi edhe një ligj për gjuhën shqipe, që sigurisht do të bëhet në bashkëpunim me të tjerët.

Më lejoni t’ju jap një rast për këtë gjë dhe të heq edhe merakun që mund të ketë pasur me të drejtë Presidenti për këtë çështje. Ju e dini që Kongresin e Drejtshkrimi të Gjuhës Shqipe e ka organizuar Akademia e Shkencave. Vërtet vendimet e Kongresit i morën akademikët, por ato u

bënë të zbatueshme në momentin kur qeveria e asaj kohe nxori vendimet e qeverisë përkatëse për t'i bërë të detyrueshme për institucionet. Si paskemi ne monopolin e gjuhës?! Ne thjesht jemi gardianët e gjuhës dhe sensibilizojmë të gjithë aktorët për t'u thënë se gjuha është në rrezik këtu apo gjuha është në rrezik atje. Aktualisht, në Këshillin e Ministrave ka një propozim për një vendim qeverie të propozuar nga Akademia e Shkencave për përdorimin e njësoar të gjuhës shqipe në institucionet publike. Na rezulton një gjendje shumë e rëndë e përdorimit të gjuhës shqipe në institucionet publike. Kam parasysh në pushtetin vendor, në aktet që nxjerr qeveria apo edhe ministritë. Kjo është detyra jonë, nuk e bëjmë monopol gjuhën, përkundrazi, sensibilizojmë nevojat që ka gjuha dhe tregojmë kujdesin ndaj saj.

Vijmë te pikat 7 dhe 14 të nenit 4. Aty specifikohen disa nga drejtimet kryesore të rolit të Akademisë dhe asamblesë si organ këshillimor. Ju thashë se asambleja ka vetëm një vendim, por një të vetëm: kur pranon anëtarët. Përsëri këtu bëhet fjalë për vlerësim, nxitje të kërkimit dhe gjërat siç i citova që mbarojnë me “on”, për shembull, “bashkëpunon”. Pra, kur thuhet që Akademia të jetë një nga garantët e respektimit të standardeve, sigurisht, kjo bëhet në bashkëpunim, së pari, me Ministrinë e Arsimit, e cila është organi qeveritar i fushës dhe ato sugjerime, që mund të bëjmë për fushat e doktoratës, që kryesisht janë orientuese, nuk e cenojnë autonominë e këtyre instituteve, përkundrazi, i sensibilizojmë për ta parë me kujdes një prioritet të caktuar në raport me një tjetër. Është parim botëror që rekomandimet apo raportet kanë gjithmonë rol ndihmues dhe nuk e cenojnë kurrë autonominë. Ai institucion, që është autonom, le ta shikojë qëndrimin tonë dhe le të vendosë brenda lirive që u jep edhe atyre ligji, në këtë rast ligji nr. 80/2015.

Në lidhje me pikën 3 të nenit 6, ku flitet për diskriminim për pranimet, për kategoritë e anëtarëve, unë dua t'ju them vetëm një gjë: është keqkuptuar një nga propozimet më brilante, që tashmë ka marrë formë ligjore, për të krijuar një akademi të gjerë me të gjithë ata shtetas shqiptarë ose me kombësi shqiptare, që e kanë fituar titullin e akademikut kur bëhet fjalë që mund të bëhen anëtarë të jashtëm, anëtarët e një akademie simotër dhe këtu kemi parasysh Akademinë e Shkencave e të Arteve të Kosovës, apo ato të vendeve ku ka akademikë shqiptarë. Sigurisht, ligji nuk thotë se do të ketë anëtarësime kolektive. Ne shprehim vullnetin që procedurat që ata kanë bërë, për standardet që ata kanë përmbushur për të qenë anëtarë të një akademie tjetër, u themi bujrum, sepse kemi të njëjtat standarde. Pra, akademitë e shkencave në Europë kanë pak a shumë të njëjtat standarde pranimi. Sigurisht, aplikimi është individual dhe kriteret se si aplikohet do të

vendosen në statut. Nuk do t'i zgjidhë ligji të gjitha këto gjëra! Prandaj, insistova në pikën që, po të ishin konsultuar, nuk do të kishte nevojë për qaq paqartësi.

Në lidhje me pikën 1 të nenit 15, kur flasim për këtë që quhet diskriminim moshor, po e sqaroj edhe një herë, më shumë për publikun që na dëgjon, ne kemi vendosur tavanet e pranimeve. Pra, kemi thënë që anëtar i asamblesë, anëtar i rregullt i asamblesë, mund të bëhesh deri në moshën 68 vjeç. Domethënë, në rast të një talenti, një shkencëtari të madh, një kërkuesi të rëndësishëm i lind e drejta që, edhe para kësaj moshe, të aplikojë për të qenë anëtar i Akademisë së Shkencave, sigurisht duke pasur titullin “professor”. Pra, titulli “professor” është kusht. Domethënë, arsyeja pse është vendosur taveni 68 lidhet me moshën e daljes në pension.

Të nderuar deputetë, ka një logjikë: ne nuk mund të pranojmë anëtarë të Akademisë ata, të cilët nuk provojnë që deri në momentin kur aplikojnë, kanë një veprimtari të pasur kërkimore-shkencore, siç e përmendi relatori i nderuar, sepse janë disa profesorë të nderuar, që në një moment të caktuar mund të mos vazhdojnë më kërkimin, por ne jemi të interesuar t'i pranojmë në një moshë vitale anëtarët e Akademisë, që të kenë mundësi që deri në moshën 75-vjeçare, kur kalojnë në statusin e meritës, ata të kenë një periudhë, një fashë kohore që të japin akoma më shumë kontribute edhe si anëtarë të Akademisë së Shkencave. Pra, nuk ka asnjë lloj kufizimi moshor, përkundrazi, ne kemi rritur pragun e tavanit për pranimet, sepse, ashtu siç u përmend këtu me të drejtë, dhe besoj se këto janë në dokumentet tuaja, fillimisht ishte më e ulët 65 dhe 60 vjeç. Pra, kemi bërë një lëshim, domethënë një diskriminim pozitiv.

Vijmë te pika 1 e nenit 19. Besoj se këtu është keqkuptimi më i madh, pasi merret ligji i Akademisë i miratuar dhe përplasat me ligjin “Për arsimin të lartë”, dhe thonë se aty parashikohet se si ngrihen njësitë e kërkimit. Sigurisht, ai ligj është shumë i saktë dhe parashikon se si ngrihen njësitë e kërkimit shkencor ose institucionet e tjera, sepse ka disa klasifikime brenda IAL-ve. Kemi një ligj të shkencës, i cili parashikon parimet e përgjithshme se si ngrihen institutet kërkimore-shkencore në të gjithë vendin, sepse u përmend me të drejtë. Qeveria ka të drejtën të ngrejë institute kërkimore - shkencore që janë pranë ministrive apo pranë institucioneve të tjera. Ligji i Akademisë çfarë bën? Nuk i konkurren këta të dy, por duke u mbështetur te e drejta që ky ligj i jep, parashikon që për çështje të veçanta me interes publik, të ngremë njësi kërkimore të përkohshme dhe njësitë kërkimore të përkohshme, e di e gjithë bota, nuk janë më shumë se 5 vjet, pra nga 2-5 vjet, në varësi të rëndësisë dhe përsëri në ligj thuhet që, në rast se qeveria do të gjykojë se Akademia duhet të ketë institute kërkimi pranë vetes së saj, sigurisht që do të shprehet me vendim qeverie. Pra, ne

krijojmë mekanizmin në rast se Kuvendi i Shqipërisë, qeveria shqiptare, organizmat ndërkombëtare do të kërkojnë një dokument shkencor për çështje të caktuara të zhvillimit të vendit nga Akademia e Shkencave. Si do t'u përgjigjemi ne, kur nuk kemi mekanizma për këtë gjë? Atëherë, mekanizmi është Njësia e Kërkimit Shkencor për një çështje të veçantë, qoftë në fushën e ekonomisë, të bujqësisë, të hidrokarbureve ose të gjuhës shqiptare. Pra, ligji në këtë rast na jep të drejtën që edhe ne të kemi mundësinë t'u përgjigjemi detyrave që na janë caktuar në këtë ligj.

Vijmë te pikat 5 dhe 6, që, pavarësisht se nuk janë të nenit 11, ku bëhet fjalë për kufizimin e kompetencës së Presidentit për çështjen e dekretimit të kryetarit të Akademisë së Shkencave, po jap qëndrimin tonë.

Në mënyrë të përmblodhur, në dekret thuhet se është provuar mospërputhja e këtyre pikave që citohen me Kushtetutën. Ndërkohë, ne besojmë se ky është një keqinterpretim i nenit 92/g të Kushtetutës dhe i ligjit "Për Akademinë e Shkencave", madje e theksoj këtë gjë: pse këto të dyja bashkë?! Sepse, sipas dekretit, thuhet se ligji i ri nuk mund të parashikojë afate mekanizmash bllokues, që nuk janë parashikuar në Kushtetutë.

Siç e përmendëm dhe po e citoj dekretin: "Edhe po të ishte e nevojshme, kjo gjë duhej të përfshihej në Kushtetutë dhe jo në ligj". Për këtë rast, dekreti nuk i referohet ligjit tonë, pra nenit përkatës, që ka të bëjë me kryetarin e zgjedhur, por citon nenin 136 të Kushtetutës, duke konkluduar se kjo nuk është harresë, pasi atë që nuk ka dashur ta bëjë Kushtetuta...

Fatjona Dhimitri – Ju bëni zgjedhjet pa bërë ligjin, zoti Tole! Si i keni bërë zgjedhjet në Akademi?!

(Deputetja Ekonomi ndërhyr pa mikrofon.)

Në rregull, vazhdoni!

Milva Ekonomi – Po diskutojmë ligjin e ri.

Fatjona Dhimitri – Po, po!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasil Tole – Po nuk më thatë "vazhdoni", nuk vazhdoj, pasi më ndërpretë fjalën!

Fatjona Dhimitri – Urdhëroni!

Vasil Tole – Faleminderit!

Të vijmë konkretisht. Neni 92/g i Kushtetutës...

(Diskutime në sallë.)

Ju lutem, zonja e zotërinj deputetë, më dëgjoni vetëm një moment!

Në nenin 92/g të Kushtetutës thuhet: “Presidenti i Republikës emëron kryetarin e Akademisë së Shkencave dhe rektorët e universiteteve sipas ligjit”, pra, ka një togfjalësh që thotë “sipas ligjit”, ndërsa në nenin 94 të Kushtetutës thuhet: “Presidenti nuk mund të ushtrojë kompetenca të tjera, përveç atyre që i njihen shprehimisht në Kushtetutë dhe që i jepen me ligje të nxjerra në pajtim me të”, siç është rasti i ligjit të Akademisë. Pra, del qartazi që vetë Kushtetuta autorizon ligjin e Akademisë së Shkencave dhe ligjin nr. 80/2015 për arsimin e lartë të përcaktojnë, në fakt, se cili është roli i Presidentit për emërimin e kryetarit të Akademisë së Shkencave apo të rektorëve të universiteteve.

Për pasojë, ligji ynë, për të cilin po flasim, ka të drejtën kushtetuese të parashikojë edhe mënyrën e zhbllokimit, në rast bllokimi, pa qenë nevoja për ndryshime kushtetuese, siç thotë Kushtetuta dhe ligji përkatës.

Vijmë konkretisht. Unë nuk kam qenë ndonjëherë ligjvënës, por të paktën, nisur nga eksperiencia që kam, nuk ka një rast në botë ose një legjislacion në botë kur deputetë të nderuar ose njësi që merren me ligjet të konstatojnë një rast bllokimi dhe ligjvënësi, që në këtë rast jeni ju, të mos ndërhyjë për të përmirësuar dispozitën ligjore. Pikërisht këtë gjë bëri ligji i ri: konstatoi një rast bllokimi të këtij procesi. Pra, ky ligj, ashtu si i mëparshmi, del në zbatim të nenit 93/g të Kushtetutës.

Është e vërtetë ajo që thatë se nuk ka ndryshuar ai nen, por edhe ky ligj, njësoj si ligji i mëparshëm, del në zbatim të po atij neni, sepse institucionet, si Akademia e Shkencave dhe IAL-të, janë institucione krejtësisht të pavarura në zgjedhjen e organeve të tyre drejtuese.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

E theksojmë që emërimi i titullarëve të zgjedhur nga institucionet e pavarura, pra të zgjedhur prej trupave, në këtë rast, dërgimi për emërim te Presidenti i Republikës, është qartazi se kjo është një kompetencë honorifike që i jepet Presidentit, i cili duhet ta ushtrojë këtë kompetencë, ashtu siç thotë neni 92/g: “sipas ligjit përkatës të institucionit” dhe në këtë rast kemi dy ligje, ligjin tonë për kryetarin dhe ligjin e IAL-ve për rektorët.

Në rast refuzimi, për arsye të tij, sepse për arsyet dhe shkeljet ligjore ne do të duhej të kishim normalisht një proces ligjor, që t’i kishte kontestuar zgjedhjet e Akademisë, ne nuk kemi një kontestim apo një vendim ligjor që t’i konsiderojë ato zgjedhje të paligjshme, përkundrazi, janë zgjedhjet më model të kryera deri sot me pjesëmarrjen e 43 nga 44 akademikëve...

Fatjona Dhimitri – Çfarë zgjedhjesh model, more zoti Tole, kur aty kanë votuar persona me moshë të madhe, persona që nuk e kanë të drejtën e votës?! Çfarë zgjedhjesh model, kur aty është zhvilluar votim me postë?! Ju e dini shumë mirë që është zhvilluar votim postar!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Bujar Çela – Je kryetare komisioni! Çfarë të duhet ty...

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Fatjona Dhimitri – Ju keni nevojë për komision hetimor, zoti Tole, pranë asaj Akademie! Nuk duhej të ishit fare këtu sot!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vazhdoni, nuk po jua mohoj të drejtën e fjalës!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasil Tole – Në fund do të bëj edhe një replikë për atë që thatë!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Pra, është organi që ka të drejtën e zgjedhjes dhe ai vendim është në fuqi tani: të vendosë rikonfirmimin ose përsëritjen e tyre. Çfarë ka bërë ligji? Pikërisht këtë gjë ka bërë. Në rast se Presidenti për arsyet e tij, thotë: “Nuk e dekretoj kryetarin e zgjedhur”, kur nuk ka arsye që lidhen me një vendim gjyqësor, i cili e pengon vërtet procesin, dhe ne jemi të ndërgjegjshëm, atëherë ligji, me të drejtë, thotë: u rikthehet atyre që e kanë zgjedhur... Kjo kompetencë, pra...

Fatjona Dhimitri – Kryetari i zgjedhur prej jush është në të njëjtën kohë edhe kryetar partie, zoti Tole! E njihni mirë statutin tuaj! Vazhdoni, vazhdoni!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Vasil Tole – Pika e fundit, dhe po ju jap përgjigje për atë që thatë më parë, ne çojmë se ka një zgjerim të kompetencës së Presidentit dhe zgjerimi i kompetencës është refuzimi i emërimit. Por Kushtetuta nuk ka refuzim për kryetarin e zgjedhur të Akademisë së Shkencave. Megjithatë, ne çojmë që kjo gjë, pavarësisht se nuk parashikohet në ligjin në fuqi, është thjesht refuzim i ushtrimit të kompetencave në këtë rast nga Presidenti dhe jo ndonjë kapërcim ligjor që kemi bërë ne, siç përmendet.

E fundit, zonja kryetare, do t’ju lutesha që për akademikët dhe Akademinë e Shkencave të flisni me respekt. Akademia e Shkencave, siç e thashë, është institucion autonom. Për sa u përket termave të komisionit hetimor, bujrum, në rast se cilido institucion e gjykon këtë gjë. Ne auditohemi rregullisht për atë buxhet modest që kemi, anëtarët e këtij komisioni e dinë buxhetin

tonë, nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Raportet vjetore të Akademisë së Shkencave, të cilat bëhen seriozisht, janë *online* dhe të publikuara në *website*-n tonë. Këto nuk përbëjnë kërcënime për ne, por ju lutem, moderoni gjuhën kur flisni për një çështje shumë serioze. Ju e dini, unë kam tre vjet që merrem me këtë proces dhe jam shumë i dëshiruar që, në bashkëpunim me ju dhe të gjithë ata që bashkëpunuan për këtë ligj, ta përmbyllim këtë proces, pasi e shikoj pa kuptim një polemikë kaq të madhe për një ligj të standardeve europiane dhe të përgatitur me kaq seriozitet nga ata që e përgatitën, sepse unë nuk kam qenë anëtar i grupit të punës.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Zoti Tole, sipas jush, ky lloj ligji sjell restaurimin politik apo akademik të Akademisë së Shkencave?

Vasil Tole – Zonja kryetare, meqë më pyetët për akademikun e nderuar Skënder Gjinushi, ai është anëtar i Akademisë së Shkencave që prej vitit '88. Pra, së bashku me Ismail Kadarenë dhe Luan Omarin, janë tre akademikët e vetëm të anëtarësisë sonë, të cilët i përkasin periudhës para viteve '90 dhe sigurisht që janë futur aty për merita të shquara. Ai është futur për arsye të talentit që ka në fushën e matematikës dhe të punimeve që ka bërë në atë fushë.

Ligji ynë aktual parashikon që ka papajtueshmëri mandatesh në momentin e kandidimit. Pra, kush ka papajtueshmëri, nuk mund të kandidojë dot, por akademik Gjinushi e zgjidhi këtë çështje, sepse njeriun nuk mund ta detyrosh të rrijë në politikë apo të zgjedhë jetën akademike. Ai vendosi dhe gjykoj që në momentin kur do kandidonte, në përfundim të procesit të reformës, në përfundim të shqyrtimeve të të gjitha aspekteve të ligjit, bëri atë procedurë që bëri, të cilën gjykata ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Fatjona Dhimitri – Vendosi katër ditë përpara kandidimit, përpara se vendimi gjyqësor të marrë formën e prerë, zoti Tole!

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Milva Ekonomi - Këtë replikë e ke komplet jashtë temës që ka komisioni sot.

Vasil Tole – Më lejoni të mbaroj fjalinë! Nuk i kam dokumentet këtu, por ju them që gjykata ka konfirmuar se në momentin kur akademik Skënder Gjinushi ka kandiduar, pra, më datën 10 maj, për pozicionin e kryetarit të Akademisë së Shkencave, ka qenë në kushtet kur nuk ishte kryetar i Partisë Socialdemokrate, por ishte vetëm anëtar i Akademisë së Shkencave. Ai e zgjidhi

me ndërgjegje këtë çështje dhe sot, aktualisht që po flasim, ai nuk është as kryetar i PSD-së dhe as kryetar i Akademisë së Shkencave. Ju lutem, merruni me këtë fakt, mos u merrni me fjalë që nuk kanë bazë!

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Faktet janë të vërtetuara, zoti Tole. Nuk kemi çfarë të shtojmë.

Urdhëroni, zoti Fadil!

Fadil Nasufi – Faleminderit, zonja kryetare!

Unë jam shumë i qartë me sqarimet shteruese që dha relatori, zoti Beqiri, por edhe me shpjegimet që dha akademiku Tole. E mira që i bëhet rishikimit të këtij ligji është pikërisht fakti që po e risjellim në vëmendje të publikut jo thjesht se po e kthen pas Presidenti, por të gjithë kemi nevojë të bëjmë sensibilizim për vlerat që ka dija, vlerat që kanë institucionet e shquara, që janë lënë në bisht në këto 30 vjet, siç është edhe Akademia e Shkencave. Kjo do të thotë që dija hap gjithmonë probleme, por problemet e dijes nuk zgjidhen me padije dhe injorancë. Kështu që, e kam të drejtën, e kam thënë edhe herë të tjera, që sa herë në këtë panel të nderuar shikoj njerëz më të ditur nga ne, e mira është të heshtim, t'i dëgjojmë, të na asistojnë, të ndihmojnë, se nuk po bëjmë një ligj rrogëtarësh, por po bëjmë një ligj të një institucioni vlerash të nëpërkëmbura dhe institucioni shkencor. Jemi investuar fuqishëm me konsulta, me dëgjesa dhe kontributet e të gjithë njerëzve më të ditur që ka ky vend në këto momente. Unë konkludoj përsëri që ligji është shumë i arrirë dhe i shkon thënies, që iu referua zoti Tole, të Noel Annam, "Akademikët pëlqejnë të japin përfundime, por nuk marrin vendime". Çfarë vendimi do të marrin këta? Çfarë ka ligji që këta të marrin vendime, veç institucionit zgjedhor që bëjnë menaxhimin e tyre të brendshëm? Është institucion i pavarur autonom.

Kështu që, në pikëpamjet e të gjitha argumenteve që solli drejtoria juridike e Presidentit, unë kam çfarë të shtoj tjetër veç definicionit që i dha me votë parlamenti në seancën e datës 18 korrik, që miratoi këtë ligj. Pastaj, pasi të shprehet relatori së bashku me juristët përkatës konstitucionalistë për ndonjë përmirësim teknik që mund të ketë, ligji duhet të kalojë përsëri në seancë plenare.

Akti tjetër që dua të tërheq vëmendjen, që iu referua në fund edhe akademiku i nderuar Tole, është që termat "refuzim" "çdekretim" "mospëlqim", që i ka tagër Presidenti, në këtë rast janë onorifike, sepse trupa zgjedhore që zgjedh kryetarin e Akademisë apo rektorin, është e miratuar qoftë me ligjin nr. 80 të vitit 2015, qoftë edhe me ligjin e ri "Për Akademinë e

Shkencave”. Para se të shkojë te Presidenti, kryetari i Akademisë së Shkencave i ka kaluar të gjithë filtrat e ankimimit dhe të gjitha ankimimet e kolegjeve zgjedhore. Ky është thjesht një akt solemn që jep pëlqimin dhe bën shpalljen, por jo refuzimin e një vendimi që është zgjedhor, siç është Asambleja e Akademikëve. Çfarë do të ndodhte nëse rektori nuk miraton dekanin? Çfarë do të ndodhte nëse dekani nuk miraton shefin e katedrës dhe të gjithë trupën e këtij ngërçi, që ndodh pikërisht se ngatërrohen termat “ratifikim”, “refuzim”, “shpallje”, apo “çdekretim” e ku di unë, se nuk jam shumë i saktë në fushat dhe termat juridikë. Prandaj, këtu ka akoma përplasje dhe keqinformime ose dashakeqësi ndaj vënies në lëvizje të miratimit të këtij ligji, si dhe vënies në eficiencë të Akademisë së Shkencave.

Zonja kryetare, e këtij komisioni të nderuar, ju sugjeroj me dashamirësi të jeni më e rezervuar ndaj kujt do që ftojme këtu, të cilët janë llogaridhënës në këtë institucion, por jo para nesh, sepse janë njerëz që ndihmojnë shtetin, shoqërinë dhe kombin, për ato vlera që përfaqëson Akademia e Shkencave.

Po ju them një shprehje të Demostenit: “Prej atij që ke mësuar të flasësh, pse nuk ke mësuar edhe të heshtësh!”.

Fatjona Dhimitri – Të heshtësh ndaj parregullsive, Fadil, të heshtësh kur ligjet mbivendosen ndaj njëri-tjetrit, të heshtësh kur shkelen kompetencat e Presidentit, sepse ky parlament po e tregon më së miri që po tejkalohen kompetencat e Presidentit!

Vazhdojmë! Kush ka pyetje?

Fidel Ylli – Unë kisha diçka. Zonja kryetare, ju them me shumë përgjegjësi që kriteret për t’u zgjedhur akademik janë shumë të forta dhe ata që e kanë fituar atë titull, mendoj se e meritojnë.

Për sa i përket asaj që thatë që zoti Gjinushi është akademik i kohës së komunizmit, mos e keni vallë fjalën që duhet të futen edhe zotërinjtë Omari dhe Kadare, sepse kanë qenë të kohës së komunizmit dhe nuk duhet të jenë akademikë?! Nuk keni pse i ndani, ose thoni edhe për zotin Kadare, për të cilin ne krenohemi që të marrë titullin atje ku ka vite dhe pretendojmë të nderojmë Shqipërinë për letërsinë që ai bën. Ju tani i fusni të gjithë në bllok. Ne nuk duhet të ngatërrohemi, se shkencëtari është shkencëtar! Zoti Gjinushi ka qenë në politikë, por ka qenë edhe në koalicion me PD-në.

Fatjona Dhimitri – Politika e udhëheq akoma shkencën, Fidel.

Fidel Ylli – Prandaj unë do të doja të përsërisja atë që tha zoti Tole, pra që kur të flasim për akademikët, duhet të kemi pak kujdes. Unë e kam ngritur gjithmonë këtë çështje, kur këta kanë

kërkuar ato buxhete që janë për lëmoshë, apo për ato zyra që i kanë me qira. Shkoni shihni zyrat e Akademisë së Shkencave të Kosovës, janë njësoj si ato të Ministrisë së Arsimit. Pra, një shtet i sapokrijuar i jep rëndësi një institucioni si Akademisë së Shkencave, kurse ne jo vetëm që nuk u japim buxhet, jo vetëm që i kemi lënë në zyra me qira, por gjithmonë mundohemi t'i denigrojmë akademikët tanë. Prandaj, unë mendoj që me ligjin e ri ne duhet t'i japim vendin e merituar Akademisë së Shkencave.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Po, urdhëroni Bujar!

Bujar Çela – Faleminderit, zonja kryetare!

Nuk dua ta bie ne përsëritje, por gjej rastin të kujtoj se kemi dy ligje për të cilat kemi bërë debat pa fund, ligji për arsimin dhe ligji për Akademinë e Shkencave.

Do të doja të përshëndesja Presidentin, i cili i dha mundësinë popullit ta mësojë ligjin përmendsh, me gjithë këtë fjalim të relatorit, për vlerësimin shumë të madh që ai i ka bërë ligjit, duke dërguar drejtoreshën e Drejtorisë Juridike dhe të Sigurisë.

Duke parë refuzimin dhe disa pika të veçanta, në një kohë kur ky ligj ka 27 nene dhe vetëm në 6 nene ka 9 vërejtje joesenciale, të cilat po t'i bësh bashkë kundërshtojnë njëra-tjetrën, unë them se Presidenti nuk ka gabuar absolutisht, por qëndron në linjën e tij politike për ta kthyer këtë dekret. Kështu që ftoj të gjithë anëtarët e komisionit, duke falënderuar akademikët dhe të gjithë të pranishmit, që të mbajmë qëndrim politik, përderisa kemi marrë përsipër ta qeverisim këtë vend, duke votuar për rrëzimin jo të Presidentit, por të këtij dekreti.

Faleminderit!

Fatjona Dhimitri – Prapë politika do të udhëheqë shkencën!

E ktheve komisionin në seancë qesharake!

Vijojmë me pyetje të tjera ndaj ekspertëve!

A ka diskutime? Nuk ka.

E hedhim në votim dekretin.

Kush është pro dekretit të Presidentit?

Sekretari i komisionit të numërojë votat!

Sa vota kemi pro dekretit të Presidentit?

Fidel Ylli – vetëm ju jeni.

Fatjona Dhimitri – Kundër dekretit?

Atëherë, rrëzohet dekreti i Presidentit!

Ju falënderoj për pjesëmarrjen!

Falënderoj edhe mediet!

Ditën e mirë!

MBYLLET MBLEDHJA